



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji,
Kulturë, Rini e Sport
Mbledhja e datës 23.06.2008
Salla nr. N.225 ora 14,00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës

P R O C E S V E R B A L

Nga mbledhja e Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport

Në mbledhje morën pjesë: Drita Kadriu, Enis Kervan, Vlora Çitaku, Adem Hajdaraj, Fatmire Berisha, Donika Kadaj-Bujupi, Heset Cakolli dhe Mark Krasniqi.
Munguan: Agim Veliu, Memli Krasniqi dhe Dragan Dimiq

Nga sekretaria e Kuvendit morën pjesë: Bajram Badivuku, Lule Ymeri dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e udhëhoqi Drita Kadriu zëvendës kryesuese e parë e Komisionit.
Për këtë mbledhje është paraparë ky:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i Projektligjit për Ansamblin Kombëtar të Këngëve dhe Valleve “Shota” dhe për Ansamblet e tjera
3. Të ndryshme.

Rendi i ditës u miratua nga anëtarët e Komisionit.

1. Procesverbali i mbledhjes së kaluar u miratua pa vërejtje.

2. Shqyrtimi i Projektligjit për Ansamblin Kombëtar të Këngëve dhe Valleve “Shota” dhe për Ansamblet e tjera.

Drita Kadriu zv. kryesuese e parë e Komisionit, si referuese e Projektligjit prezantoi para anëtarëve të tjerë të Komisionit propozim amendamentet e Projektligjit për Ansamblin Kombëtar të Këngëve dhe Valleve “Shota” dhe për Ansamblet e tjera. Anëtarët e Komisionit filluan me leximin nen për nene të Projektligjit dhe propozuan këto amendamente:

Amendamenti 1

Preambula riformulohet :

“ **Kuvendi Republikës së Kosovës**

Në bazë të nenit 65.1 dhe 80.6 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me qëllim të krijimit të infrastrukturës dhe rregullativës ligjore përkitazi me veprimtarinë, aktivitetet dhe funksionimin institucional të Ansamblit Kombëtar - Shtetëror të Këngëve dhe Valleve “Shota” dhe të ansambleve të tjera,

Miraton

Projektligjin për Ansamblin Kombëtar të Këngëve dhe Valleve “Shota” dhe për Ansamblet e tjera

Amendamenti 2

Titulli i projektligjit ndryshohet:

“Projektligji për Ansamblin Kombëtar- Shtetëror të Këngëve dhe Valleve “Shota” dhe për Ansamblet e tjer”

Ndryshimi vlenë për tërë tekstin e projektligjit.

Amendamenti 3

Neni 1

Riformulohet:

“Me këtë Ligj rregullohet funksionimi i veprimtarisë së Ansamblit Kombëtar-Shtetëror të Këngëve dhe Valleve “ Shota”(në vijim të tekstit *Ansambi “Shota”*) dhe të ansambleve të tjera kulturore dhe artistike, themelimi, drejtimi, menaxhimi dhe financimi i tyre, pozita e artistëve dhe çështje tjera të rëndësishme për këtë veprimtari”.

Paragrafi 2 i nenit 1 me pikat a, b, c, d, e fshihen.

Amendamenti 4

Riformulohet neni 2

Titulli: **“Përkufizimet”**

“Në zbatim të këtij ligji termat vijues kanë këto kuptime”

Ansambli “Shota” – është Ansambël Kombëtar -Shtetërorë i këngëve dhe valleve (në tekstin e mëtejme Ansambli “Shota”

Veprimtari kulturo-artistike e këngëve dhe valle - sipas këtij Ligji, përkufizohet përgatitja dhe shfaqja publike e veprave skenike të këngëve dhe valleve artistike kombëtare.

Ansamblet - janë shoqëri kulturore artistike publike apo private veprimtaria e së cilave ka për qëllim realizimin e aktiviteteve kulturore që shprehet në këngë, valle dhe koreografi (në tekstin e mëtejshëm dhe ansamblet tjera)

Këshill artistik - është organ kolegjal profesional, këshilldhënës dhe vendimmarrës në sferën artistike profesionale.

Udhëheqës artistik - është personi përgjegjës profesional i Ansambilit në sferën artistike.

Seksione - janë njësi organizative brenda Ansambilit që përcaktojnë strukturën vepruese dhe artistike.

Projekt - konsiderohet çdo ide e zhvilluar dhe e plotësuar deri në nivelin e shpjegimit të kuptueshëm, duke përfshirë të gjitha elementet e nevojshme për realizimin e aktiviteteve

Aplikim - konsiderohet kërkesa e ansambilit “Shota” dhe ansambleve tjera për financim nga fondet publike për realizimin e një ose më shumë projekteve

Mbështetje financiare - konsiderohet masa e financimit të ansambilit “Shota” dhe ansambleve tjera nga fondet publike”.

Amendamenti 5

Neni 3 riformulohet:

“II. INSTITUCIONET E ANSAMBLEVE DHE ORGANIZIMI I TYRE

Ansambli “Shota” dhe Ansamblet e tjera, ushtrojnë veprimtari kulturore.- artistike me interes të veçantë”.

Amendamenti 6

Neni 4 riformulohet:

“Veprimtarinë kulturo-artistike të këngëve dhe valleve kanë të drejt ta ushtrojnë të gjithë personat fizikë dhe juridikë, pa dallim etnie, race e gjinie.

Amendamenti 7

Titulli Kapitulli II fshihet

Neni 5 riformulohet

“Veprimtaria e Ansambilit “Shota”

Veprimtaria e ansambleve është me interes të veçantë për publikun, prandaj investimi në këtë veprimtari dhe shfrytëzimi i fondeve publike është e drejtë legjitime. Përdorimi i fondeve publike e përjashton mundësinë e ndërhyrjes në lirinë artistike”.

Amendamenti 8

Neni 6 riformulohet

Veprimtaria e ansambleve të këngëve dhe valleve zhvillohet në këto nivele:

- a) Ansambli Kombëtar-Shtetëror i Këngëve dhe Valleve “Shota”
- b) Ansamblet profesionale të qyteteve
- c) Ansamblet private
- d) Grupet e vallëtarëve

Amendamenti 9

Neni 7 riformulohet

Ansambli Kombëtar-Shtetëror i Këngëve dhe Valleve “Shota” dhe Ansamblet e tjera ushtrojnë veprimtarinë e tyre sipas këtij Ligji .

Amendamenti 10

Neni 8 riformulohet

Ansamblet mund të jenë në pronësi publike dhe private.

Amendamenti 11

Neni 9 riformulohet

Në pronësi publike janë :

- a) Ansambli Kombëtar - Shtetëror i Këngëve dhe Valleve “Shota”, themelohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës,
- b) Ansamblet profesionale të qyteteve, themelohen nga Kuvendet Komunale në bashkëpunim me MKRS.

Amendamenti 12

Shtohen tri nene : Neni 10; Neni 11; dhe Neni 12

Neni 10 shtohet

“Ansamblet publike themelohen nëse janë plotësuar kushtet materiale, teknike të kuadrove dhe kushtet e tjera të përcaktuara me këtë ligj.

Neni 11 shtohet

Vendimin për themelimin e ansambleve publike e merr Ministria e Kulturës dhe organet kompetente komunale.

Neni 12 shtohet

Ansamblet private dhe grupet e valltarëve mund të jenë në pronësi të personave fizikë dhe juridikë.

Amendamenti 13

KAPITULLI III

ORGANIZIMI I BRENDSHËM DHE FUNKSIONIMI

Seksionet

Neni 10 dhe Neni 11

Fshihen dhe zëvendësohet me:

“KREU i III-të

ANSAMBLI KOMBËTAR-SHTETËROR I KËNGËVE DHE VALLEVE “SHOTA”

Në vazhdim bëhet rregullimi i neneve sipas rradhës

Neni 13

Ansambli Komëtar-Shtetror i Këngëve dhe Valleve “Shota” është institucion publik artistik i Kosovës me seli në Prishtinë.

Neni 14

Amsambli “Shota” i ka simbolet e veta identifikuese, institucionale dhe artistike ,si : stemën dhe vulën e mëvetsishme.

Neni 15

Veprimtaria e Ansamblit “Shota” përfshinë:

- a) Përgatitjen;
- b) Organizimin dhe
- c) Shfaqjen publike të koncerteve dhe të formave tjera skeniko-muzikore.

Neni 16

Ansambli “Shota” nxit, zhvillon, avancon, publikon dhe promovon artin kombëtar dhe arte të tjera në vend dhe jashtë vendit nëpërmjet :

- a) Harton politikat dhe propozon masat për ngritjen e cilësisë profesionale në fushën e artit skenik muzikor,
- b) Paraqitjeve publike në koncerte skeniko-muzikore
- c) Audio dhe video regjistrimeve si dhe materialeve tjera promovuese të programeve artistike kombëtare dhe të tjera,
- d) Bashkëpunimit me ansamblet tjera të vendit dhe ndërkombëtare.

Neni 17

Ansambli “Shota” është i obliguar që ta ruajë vulën, dokumentacionin, mjetet e punës, rekuizitat, instrumentet, kostumet dhe pasurinë tjetër të Ansamblit.

Neni 18

Dokumentacioni i Ansamblit “Shota” ruhet në vende, orendi dhe në stabilimente përkatëse, në përputhje të plotë me Ligjin për ruajtjen e materialit arkivor dhe me standardet bashkëkohore.

Neni 19

Ansambli “Shota” punën dhe veprimtarinë profesionale e zhvillon në seksione:

- a) Seksionin e valltarëve dhe të këngëtarëve
- b) Seksionin e orkestrës
- c) Seksionin e solistëve vokal dhe të korit
- d) Seksionin teknik profesional
- e) Seksionin e stafit artistik

Këshilli Drejtues i Ansamblit “Shota”

Neni 20

Këshilli Drejtues është organ i pavarur që mbikqyrë punën e menaxhmentit dhe administratës së Ansambli “Shota”.

Neni 21

Këshilli Drejtues i Ansamblit zgjedhet nga Ministri i MKRS dhe përbëhet nga 7 anëtarë me mandat katërvjeçar, dhe njejtë mund të rizgjedhet.

Këshilli drejtues ka këtë përbërje:

- a) Një (1) anëtar nga Ministria e Kulturës;
- b) Një (1) anëtar nga Drejtorati i Kulturës i Kuvendit Komunal të Prishtinës;
- c) Një (1) anëtarë nga shoqëria civile, me propozim të Këshillit artistik punonjës-krijues artistikë të dalluar, etj;
- d) Një (1) anëtarë nga radhët e komuniteteve,
- e) Tre (3) anëtarë punëtorë profesional në marrëdhënie pune nga radhët e institucionit të Ansamblit të përfaqësuar nga çdo seksion.

Neni 22

Këshilli drejtues nga radhët e veta zgjedh kryetarin me mandat katërvjeçar i cili mund të rizgjedhet.

Neni 23

Këshilli Drejtues i Ansamblit “Shota” ka për detyrë të:

- a) miratojë Statutin e ansamblit ;

- b) nxjerrë dhe të miratojë rregulloret dhe aktet e ndryshme normative që rregullojnë marrëdhënie të caktuara nga veprimtaria e ansamblit ;
- c) miratojë programin e punës të ansamblit ;
- d) miratojë planin financiar dhe llogarinë përfundimtare të ansamblit;
- e) zgjedhë dhe emërojë drejtorin e ansamblit;
- f) zgjedhë udhëheqësin artistik të Ansamblit
- g) zgjedhë dhe emëroj punëtorët e rregullt dhe bashkëpunëtorët e angazhuar nga jashtë;
- h) kryejë edhe detyra të tjera të përcaktuara me këtë ligj dhe me statutin e Ansamblit.

Neni 24

Kryetari i Këshillit drejtues i konvokon dhe i udhëheqë mbledhjet e Këshillit drejtues. Mbledhjet e Këshillit Drejtues ftohen edhe me kërkesën e 2/3 të anëtarëve të Këshillit Drejtues.

Neni 25

Këshilli Drejtues i Ansamblit mund të punojë dhe të vendosë nëse në mbledhjet e tij janë të pranishëm 2/3 e anëtarëve të Këshillit Drejtues.

Neni 26

Mënyra e punës, kompetencat dhe autorizimet e Këshillit Drejtues rregullohen me aktin nënligjor përkatës.

Këshilli Artistik i Ansamblit “Shota “

Neni 27

Këshilli Artistik ka 9 anëtarë dhe përbëhet nga:

- a) Drejtori;
- b) Udhëheqësi artistik i Ansamblit;
- c) Tre (3) përgjegjës të seksioneve;
- d) Dy (2) punonjës nga Ansambli,
- e) Dy (2) ekspertë nga rradhët e shoqërisë civile .

Neni 28

Këshilli Artistik nga rradhët e veta zgjedh kryetarin me mandat katërvjeçar i cili mund të rizgjedhet.

Neni 29

Dy anëtarë të rregullt, punonjës të Këshillit Artistik të Ansamblit, zgjedhen drejtpërsëdrejti nga punëtorët e Ansamblit.

Neni 30

Anëtarët e jashtëm të Këshillit Artistik të Ansamblit delegohen nga institucionet përkatëse, përkatësisht nga shoqëria civile në suaza të procedurës së përcaktuar me ligj dhe me akte të përgjithshme të institucionit ose të strukturës e cila e delegon anëtarin në Këshill Artistik të Ansamblit.

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E KËSHILLIT ARTISTIK

Neni 31

Këshilli Artistik i Ansambilit „Shota“ ka për detyrë :

- a) Të hartojë, shqyrtojë dhe propozojë programin artistik vjetor të Ansambilit.
- b) T’ia propozojë Këshillit Drejtues kahjet e përgjithshme të politikës së repertuarit.
- c) Të bëjë vlerësimin artistik të koncerteve dhe të aktiviteteve të tjera kulturore si dhe të japë sugjerime për konceptin e programit të Ansambilit.

Udhëheqësi Artistik i Ansambilit

Neni 32

Me propozim të Këshillit Artistik, udhëheqësin artistik e zgjedh Këshilli Drejtues i Ansambilit .

Neni 33

Udhëheqësi artistik i Ansambilit është person përgjegjës profesional i Ansambilit, me përgatitje profesionale universitare në fushën e arteve skenike- muzikore, me përvojë së paku pesëvjeçare në fushën e artit dhe kulturës

Neni 34

Udhëheqësi artistik i Ansambilit për punën e tij i përgjigjet drejtpërsëdrejti, në shkallë të parë drejtorit të ansambilit, ndërsa në shkallë të dytë Këshillit artistik dhe Këshillit Drejtues të tij.

Monitorimi dhe mbikëqyrja e punës të Ansambilit

Neni 35

Monitorimin e rregullt dhe mbikëqyrjen e punës e të zbatimit të ligjshmërisë për Ansamblin Kombetar - Shtetror “Shota” Ministria e Kulturës, ndërsa për Ansamblet në nivel komunal mbikëqyrjen e bën Drejtoria përkatëse e kulturës, në bashkëpunim me MKRS përkatësisht themeluesin.

Drejtori i Ansambilit

Neni 36

Drejtori i Ansambilit “Shota” është udhëheqës i Ansambilit dhe organ ekzekutiv i tij.

Autorizimet, detyrat dhe përgjegjësitë

Neni 37

Në cilësi të udhëheqësit të ansamblit drejtori kryen këto punë:

- a) Udhëheq punën e Ansamblit;
- b) E përfaqëson dhe përgjigjet për veprimtarinë materiale-financiare dhe për ligjshmëri e Ansamblit ;
- c) Zbaton programin vjetor të punës me pëlqimin paraprak të Këshillit Drejtues ;
- d) Zbaton vendimet e Këshillit Drejtues dhe të Këshillit artistik ;
- e) Propozon aktin për organizimin, sistematizimin e vendeve të punës dhe aktin për ndarjen e pagave, sipas ligjit, të cilat i miraton Këshilli Drejtues ;
- f) Në rast të moszgjedhjes së udhëheqësit artistik, me propozim të Këshillit Artistik, mund të emërohet ushtruesi i detyrës së udhëheqësit artistik për një afat gjashtëmuor ;
- g) Me propozim të udhëheqësit artistik dhe të këshillit artistik mbikëqyr punën dhe aktivitetet artistike të trupave artistike dhe këshillëdhënëse të përherëshme dhe të përkohshme në pajtim me ligjin ;
- h) Merr pjesë në punën e Këshillit Drejtues dhe të komisioneve pa të drejtë vote .

Neni 38

Drejtori zgjedhet në bazë të konkursit publik të shpallur nga Këshilli Drejtues me propozim të Këshillit Artistik.

Neni 39

Për drejtor të ansamblit zgjedhet personi me përgatitje univerzitare, me përvojë së paku pesë vjeçare në fushën e artit dhe të kulturës.

Neni 40

Kushtet për zgjedhjen, përkatësisht emërimin e drejtorit të Ansamblit “Shota” caktohen dhe zbatohen në përputhje me ligjin, me aktin për themelimin dhe me statutin e ansamblit.

Neni 41

1.Drejtori i Ansamblit “Shota” zgjidhet me mandat prej 4 vjetësh me mundësi të rizgjedhjes.

2..Drejtorin e Ansamblit “Shota“e emëron dhe shkarkon Këshilli Drejtues sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me ligjin në fuqi.

Neni 42

Ndërprerja e punës dhe shuarja e veprimtarisë

Puna dhe veprimtaria e Ansamblit “Shota” ndërpritet, përkatësisht shuhet në përputhje me ligjin në fuqi ,ndërsa vendimin përfundimtar e merr Kuvendi i Republikës së Kosovës në bazë të propozimit të Ministrit të Ministrisë së Kulturës.

Ansamblet profesionale publike te komunave

Neni 43

Ansamblet profesionale publike mund të themelohen nëse janë plotësuar kushtet e parapara me ligj. Komunitat mund të themelojnë ansamble publike profesionale sipas nevojave dhe interesave të komuniteteve.

Neni 44

Dispozitat e këtij ligji për administrimin e ansamblit “Shota” aplikohen edhe në organizimin dhe funksionalizimin e ansambleve profesionale të komunave.

Neni 45

Ansamblet profesionale të komunave janë në përgjegjësi të komunave..MKRS mund të mbështetë financiarisht projekt-programet deri në 50% (Pesëdhjetë për qind) të fondeve.

Ansamblet private dhe grupet e vallëtarëve

Neni 46

Ansambel privat mund të formoj çdo person fizik apo juridik,

Neni 47

Për themelimin e ansamblit privat është i nevojshme regjistrimi si subjekt juridik në organeve kompetente.

Neni 48

Ansambli privat themelohet nëse janë plotësuar kushte e parapara me ligj punëtorëve si dhe kërkesave tjera të parashikuara nga themeluesi i ansamblit.

Neni 49

Ansamblet private themelohen me mjete vetanake të personave fizik ose juridik.

Neni 50

Ansamblet private janë të lira të kontraktojnë shërbimet e projektit në kushte e tregut.

Neni 51

Projektet e ansambleve private mund të mbështeten financiarisht edhe nga buxheti i MKRS si dhe nga buxheti i komunës në të cilën vepron.

Amendamenti 14

KAPITULLI IV i Projektligjit fshihet me nenet në vazhdim.

Amendamenti 15

KAPITULLI V i Projektligjit fshihet me nenet në vazhdim

Amendamenti 16

KAPITULLI VI i Projektligjit fshihet me nenet në vazhdim

Amendamenti 17

KAPITULLI VII i Projektligjit “FINANCIMI I ANSAMBLIT “SHOTA “ fshihet me nenet në vazhdim dhe zëvendësohet me :

KREU IV

Financimi

Neni 52

Ansambli “Shota” dhe ansamblet tjera publike janë institucione buxhetore ose gjysëm-buxhetore,që krijohen ose transformohen në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në zbatimin e këtij ligji.

Neni 53

Mjete për punën e ansambleve publike sigurohen nga :

- a) Buxheti i MKRS
- b) Buxheti komunal,
- c) Të hyrat vetanake të realizuara nga veprimtaria artistike
- d) Sponsor,donatorë,dhurata dhe të hyra tjera.

Neni 54

Mjetet për punën e ansambleve private sigurohen nga:

- a) Pronarët e ansambleve
- b) Të hyrat vetanake të realiyuara nga veprimtaria e teatrit
- c) Sponsorë,donatorë,dhurata dhe të hyra tjera.

Neni 55

Bazuar në kërkesat e projekteve vjetore të ansambleve publike, MKRS harton për çdo vit kalendarik kriteret për mbështetje financiare të kesaj veprimtarie.

Neni 56

MKRS obligohet t'i publikoje procedurat e aplikimit për mbështetje financiare.

Neni 57

Revizionin dhe mbikëqyrjen financiare të punës dhe të veprimtarisë së ansamblit e bën themeluesi dhe autoriteti ligjor, i autorizuar të paktën njëherë në vit.

Amendamenti 18

Titulli VIII i Projektligjit fshihet zëvendësohet me

KREU V. DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 58

Pëlqimin për zbatimin e akteve nënligjore të ansambleve publike e jep themeluesi, përkatësisht Ministria e Kulturës.

Neni 59

1 Pas shpalljes të këtij ligji Ansambli “Shota”, është i obliguar që brenda afatit prej 6 muajsh t’i harmonizojë të gjitha aktet përkatëse me këtë ligj.

2. Institucionet e tjera që merren me veprimtari të njëjtë, janë të obliguara sipas këtij ligji të themelohen, regjistrohen dhe licensohen .

Neni 60

Ministria e Kulturës, është e obliguar që brenda afatit prej 90 ditësh nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, t’i nxjerrë të gjitha aktet nënligjore të parashikuara me këtë ligj.

Neni 61

Organet udhëheqëse të ansamblit i ushtrojnë funksionet e veta deri në zgjedhjet dhe emrimet e organeve të reja në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

Neni 62

Me hyrjen në fuqi të këtij Ligji, pushojnë së vlejtori të gjitha dispozitat ligjore dhe nënligjore që rregullojnë këte çështje.

Neni 63

Ky ligj hyn në fuqi pas miratimit në Kuvendin e Republikës së Kosovës, përkatësisht në ditën e nënshkrimit të tij nga Presidenti.

Jakup Krasniqi
Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës”.

Amendamentet e propozuara u miratuan nga të gjithë anëtarët e pranishëm.

3. Të ndryshme

Mbledhja e ardhshme e Komisionit do të mbahet të hënën e ardhshme në orën 14,00

Mbledhja përfundoi në orën 16,15

Zv e parë e Komisionit,
Drita Kadriu